



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 maj 2014  
Nr.ref.: RK633/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI231/13**

Parashtrues

**Alisait Qerimi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në  
Prishtinë, Ac. nr. 4375/2012, të 4 korrikut 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Alisait Qerimi, me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi kërkon shqyrtimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 4375/2012, të 4 korrikut 2013, i cili është pranuar nga parashtruesi më 29 gusht 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, me të cilin pretendohet shkelje nga neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nga neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 27 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 15 janar 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI231/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI231/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 29 janar 2014, Gjykata e njoftoi dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Prokurorit të Shtetit dhe palës së tretë, F. Q.
8. Më 30 janar 2014, Gjykata kërkoj nga parashtruesi informata nëse ka pranuar ndonjë vendim lidhur me ankesën e tij të 20 nëntorit 2013 përkitazi me procedurën përmbartimore.
9. Më 5 shkurt 2014, parashtruesi e njoftoi Gjykatën se ende nuk e ka pranuar aktvendimin lidhur me ankesën e tij të 20 nëntorit 2013 përkitazi me procedurën përmbartimore.
10. Më 14 mars 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 23 tetor 2012, Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktvendimin C. nr. 354/09, e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit F. Q., e ushtruar kundër parashtruesit, dhe

vërtetoi se parashtruesi e ka penguar paditësin F. Q. në shfrytëzimin e bodrumit, i cili gjendet në kuadër të shtëpisë individuale për banim. Gjykata Komunale e obligoi parashtruesin që të mos e pengojë paditësin F. Q. në shfrytëzimin e bodrumit. Parashtruesi u ankua në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër këtij aktvendimi.

12. Më 4 korrik 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 4375/2012, e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, të 23 tetorit 2014. Gjykata konstatoi se *“Gjykata në këto konteste afron mbrojtje gjyqësore sipas gjendjes së fundit faktike të posedimit pa u lëshuar në të drejtën e posedimit apo të pronësisë për të cilat ndërgjyqësit kanë konteste të tjera, duke u nisur nga fakti se me provat e administruara gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë në posedim të fundit faktik të podrumit kontestues, prandaj me të drejtë e ka miratuar kërkesëpadinë e tij si të bazuar”*.
13. Më 11 gusht 2013, parashtruesi ushtroi propozimin për përsëritjen e procedurës civile në Gjykatën Themelore në Gjilan, për shkak se:
  - a. Parashtruesi për arsye objektive nuk ka mundur të marrë pjesë në seancën pranë Gjykatës Komunale në Gjilan;
  - b. Se deklarata e një dëshmitari është ndryshuar në Gjykatën Komunale në Gjilan; dhe
  - c. Të dëgjohen edhe disa dëshmitarë të tjerë.
14. Më 16 shtator 2013, paditësi F. Q. paraqiti propozimin për përmbarim në Gjykatën Themelore në Gjilan, të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 354/2009, të 23 tetorit 2012.
15. Më 16 shtator 2013, Gjykata Themelore në Gjilan, me Aktvendimin E. nr. 1118/13, caktoi përmbarimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C. Nr. 354/2009, të 23 tetorit 2012.
16. Më 7 tetor 2013, parashtruesi paraqiti kundërshtim kundër Aktvendimit E. nr. 1118/13, të 16 shtatorit 2013.
17. Më 15 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Gjilan, me Aktvendimin CP. nr. 1118/2013, refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit.
18. Më 20 nëntor 2013, parashtruesi paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, CP. nr. 1118/2013, të 15 nëntorit 2013, për shtyrjen e përmbarimit. Parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi nëse ka pranuar ndonjë vendim në këtë rast.
19. Më 5 dhjetor 2013, Prokurori i Shtetit njoftoi parashtruesin se kërkesa e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka gjetur bazë ligjore për ngritjen e kërkesës së mbrojtjes së ligjshmërisë.

## **Pretendimet e kërkesës së parashtruesit**

20. Parashtruesi pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr.6 354/09, të 23 tetorit 2012, me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 4375/2012, të 4 korrikut 2013, me propozimin për përmbarim, CP. nr. 1118/13, të 16 shtatorit 2013, me Aktvendimin Cp. nr. 1118/2013, të 15 nëntorit 2013, janë cenuar të drejtat e tij nga neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

## **Pranueshmëria e kërkesës**

21. Në mënyrë që të jetë në gjendje ta shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohet më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

23. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, që parashohin:

*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*[...]*

*(c) Kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;*

*[...]*

*d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

24. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit pretendon shkeljen e neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

25. Por, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka qartësuar se si dhe pse këto të drejta kushtetuese janë shkelur me vendimin e kontestuar. Pakënaqësia me vendimin ose thjesht përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendon për shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi duhet të ofrojë një argument bindës dhe të arsyetuar mirë në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.

26. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në këtë rast. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin KI14/13, parashtruesi i kërkesës *Komuna e Podujevës*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 12 marsit 2013).
27. Për më tepër, vendimi i Gjykatës së Apelit ka dhënë arsyetim përkitazi me faktet e rastit dhe gjetjet e tyre.
28. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi nuk ka arritur t'i arsyetojë pretendimet e tij dhe të dorëzojë dëshmi për të mbështetur pretendimet për shkelje kushtetuese të shkaktuar nga vendimi i kontestuar.
29. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) dhe (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) a) si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 14 mars 2014, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Arta Rama-Hajrizi



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani